



Prishtinë, 05 qershor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1157_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin të ndërtuar në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 210-51, ZK Lleshan, me kapacitet të instaluar prej **5 kW** në Komunën e Pejës, të datës 19.04.2019 me nr. prot. 245/2019 të aplikuesit Bashkim Atashi, me adresë: fshati "Lleshan", Komuna e Pejës, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 05 qershor 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET**- kërkesa e aplikuesit Bashkim Atashi, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastrada kadastrave Nr. 210-51, ZK Lleshan, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Pejës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi Bashkim Atashi, me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPE- 9024690 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtoj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi Bashkim Atashi, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

Arsyetim




- ZRRE, me datë 19.04.2019 nga aplikuesi Bashkim Atashi, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, mbi objektin e ndërtuar në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 210-51, ZK Lleshan, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, që do të vendosen mbi objekt, shifra e konsumatorit DPE- 9024690, Komuna e Pejës.
- Aplikuesi, s'bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 1685 të datës 15.03.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., projektin ekzekutues dhe Pëlqimin Nr. 08-350/9458 të datës 22.01.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Pejës.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit Bashkim Atashi, dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e shtëpisë individuale të ndërtuar në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 210-51, ZK Lleshan, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Pejës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.